REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI ALEKSANDER MOISIU
FAKULTETI I BIZNESIT
DEPARTAMENTI I TURIZMIT

Nr.668 prot
20.09.2023

Durrës, më 13 /09 /2023

Lënda : Raport i Vlerësimit të brendshëm për programin e ciklit të parë të studimit Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim Hotel Restorant

Drejtuar: DEKANIT TË FAKULTETIT TË BIZNESIT

PROF. DR. SHKËLQIM FORTUZI

I nderuar Z. Dekan,

Në kuadër të procesit të akreditimit të programeve të studimit , Grupi i vlerësimit të brendshëm në programin e studimit Menaxhim Turizwm me profil Menaxhim Hotel Restorant, ju përcjellim raportin e vlerësimit të brendshëm dhe evidencat mbështetëse për këtë program studimi.

Duke ju falenderuar,

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Brunilda Licaj — Koordinator i programit te studimit
2. Mirela Tase — Staf Akademik me kohë të plotë
3. Dorina Xheraj — Staf Akademik me kohë të plotë
4. Nevila Cinaj — Staf Akademik me kohë të plotë
5. Xhulia Luli — Studente e Programit
6. Dashamir Kallucu — Perfaqësues biznesi FAFA Resort
7. Spiro Paco — Koordinator Institucional I IAL-së për ASCAL
8. Marsida Dyrmishi — Specialist DKSC

Universiteti `Aleksandër Moisiu` Durrës

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Menaxhim Turizëm" me profil "Menaxhim Hotel-Restorant"

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Brunilda Licaj (Kryetar)
2. Dr. Nevila Cinaj (Anëtare)
3. Dr. Dorina Xheraj (Anëtare)
4. Dr. Mirela Tase (Anëtare)
5. Xhulia Luli (Studente)
6. Dashamir Kallucu perfaqesues Biznesi FAFA Resort
7. Marsida Dyrmishi (Specialiste, Sektori i Kurrikulës, Cilësisë dhe Standarteve)
8. Dr. Spiro Paco (Drejtor i Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Standarteve)

Muaji/Viti

Korrik / 2023

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Përshkrim përmbledhës

I themeluar në vitin 2005, Universiteti "Aleksandër Moisiu" është një institucion relativisht i ri i Arsimit të Lartë në vend, por njëkohësisht ndër më të rëndësishmit duke luajtur rol të vecantë në formimin e specialistëve dhe kërkuesve nga fushat të ndryshme. Edukimi në nivel të lartë cilësor dhe transmetimi i dijeve është jo vetëm përgjegjësi e institucionit, por njëkohësisht përgjegjësi morale e qytetare përballë formimit të profesionistëve të së ardhmes, komunitetit e mbarë shoqërisë.

Departamenti i Turizmit, si një ndër njësitë bazë të Fakultetit të Biznesit ofron një program studimi të ciklit Bachelor në Turizëm dhe Menaxhim Turizëm me profil Hotel Restorant. Programi Menaxhim Turizëm me profil Menxhim Hotel- Restorant është i hapur gjatë vitit akademik 2009 -2010 me Urdhër Nr 685 të Ministres së Arsimit, Rinisë dhe Shkëncës, datë 25.8.2010 Mbështetur në Ligjin 80/2015, ky program studimi është i përfshirë në procesin e akreditimit, në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Vleresimi i ketij programi studimi nga grupi i ekspertëve të vlerësimit të brendshëm (GVB) është fokusuar në 6 fusha kryesore, si :

1. Ofrimi i programit të studimit dhe përputhshmëria e tij me interesat kombëtare, misionin dhe vizionin;
2. Mënyra e organizimit, drejtimit dhe administrimit të programit të studimit;
3. Në nivel të mësimdhënies e mësimnxënies, vlerësimit të studentëve dhe kompetencat e fituara prej tyre;
4. Mbështetja e programit të studimit me burimet e nevojshme njerëzore, financiare, infrastrukturore dhe logjistikën e nevojshme për realizimin e tij;
5. Politikat dhe procedurat që ndiqen për mbështetjen e studentëve;
6. Sigurimi i cilësisë së programit të studimit.

Nga analiza e kryer për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, GVB konkludon që programi i ofruar në ciklin e parë të studimit Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim Hotel- Restorant përmbush plotësisht (100%) standartet; në fushën e organizimit, drejtimit dhe administrimit përmbush plotësisht (100%) standartet; në mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësimin dhe kompetencat përmbush plotësisht (100%) standartet; në burimet për realizimin e programit të studimit përmbush plotësisht (100%) standartet; në lidhje me studentët dhe mbështetjen e tyre përmbush plotësisht (100%); dhe në sigurimin e cilësisë së programit të studimit përmbush plotësisht (100%) standartet.

Në përfundim, nga analiza e kryer për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, GVB konkludon që programi në ciklin e parë të studimit Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim Hotel- Restorant i ofruar nga Departamenti i Turizmit pranë FB, i përmbush plotësisht standartet për tu akredituar

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM;

Përshkrim përmbledhës

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e ciklit të parë të studimit Bachelor Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim "*Hotel-Restorant*" është përgatitur nga grupi i ekspertëve të vlerësimit të brendshëm (GVB), i ngritur me MEMO dt.10.07.2023 drejtuar autoritetit të Dekanit të Fakultetit Biznesit, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR, ASCAL dhe Statutin e UAMD-së.

Përbërja e GVB është percaktuar mbi bazën e disa kritereve që lidhen me aftësitë dhe kompetencat profesionale të tyre në mësimdhënëse dhe kërkim shkencor, në integritetin dhe aftësitë e tyre për një analizë dhe vlerësim të paanshëm të dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm për kryerjen e proçesit të akreditimit. Në përbërjen e grupit është i përfshirë një studente dhe një përfaqësues nga bizneset e sektorit të hotelerisë me të cilin departamenti ka marrveshje bashkëpunimi.

GVB për realizimin e procesit të vlerësimit të këtij programi studimi është bazuar në kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, udhëzimet dhe manuale të ASCAL-it, Statutin dhe Vendimet e Senatit Akademik të UAMD-së.

GVB në mbledhjen e informacionit, përpunimin e tij dhe hartimin e RVB, ka operuar duke ndarë ndërmjet anëtarëve të grupit të punës detyrat dhe përgjegjësitë duke synuar arritjen e përfundimeve objektive e reale në funksion të vlerësimit të cilësisë të këtij programi studimi.

GVB ka mbledhur dhe analizuar të dhëna dhe informacione të nevojshme në nivel institucioni, fakulteti dhe departamenti, për të realizuar procesin e vlerësimit të programit të studimit, të cilat në mënyrë përshkruese janë pasqyruar sipas rubrikave të fushave të përcaktuara në RVB dhe të dhënat mbështetëse, dokumentacioni bazë, të kërkuara për procesin e akreditimit të programit të studimit janë pasqyruar në formë aneks-i bashkëlidhur, referuar modelit të hartuar nga ASCAL në përputhje me kërkesat ligjore për sigurimin e cilësisë në IAL-të. RVB i strukturuar në gjashtë fusha operacionale me standarde dhe kriteret përkatëse, mbi bazën e të cilave, referuar dhe në dokumentacionin mbështetës faktik, është bërë vlerësimi i përmbushjes të standardeve të cilësisë ndaj programit të ofruar.

Programi Bachelor Menaxhim Turizëm me profil `***Menaxhim Hotel-Restorant***` po hyn për herë të parë në akreditim që nga momenti i hapjes si program.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim Hotel-Restorant"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 **Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Po. Universiteti "Aleksandër Moisiu", dhe Fakulteti Biznesit si një ndër njësitë kryesore të tij, ofrojnë programe studimi në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim dhe zhvillim[1 2 3 4 5 6 7]. Programi i studimit "*MTMHR*", që ofrohet nga institucioni respekton interesat kombëtare, gjë e cila shprehet në misionin dhe qëllimin e tij. Ky program synon përgatitjen e specialistëve dhe kërkuesëve në fushën e turizmit, të aftë në vendimarrje dhe drejtim të ndërmarrjeve turistike,[8] nuk bie ndesh me interesat kombetare, por nxit pasurimin e vlerave të tyre. Programi i studimit, "*MTMHR*" shpreh qartazi që në mënyrën e hartimit të tij mbështetjen në përvojën akademike e kulturore, ndaj kerkesave të kohes dhe perspektives së zhvillimit të vendit dhe synon ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare[9]. UAMD pavarësisht se është një institucion relativisht i ri në tregun akademik shqiptar ka ndjekur një politikë për ruajtjen e konsolidimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore[10]. Në hierarkinë e vlerave të Fakultetit të Biznesit, si një prej Njësive Kryesore qëndron dimensioni njerëzor dhe vullnetarizimi, mendimi dhe veprimi intelektual, aktiviteti i përbashkët dhe puna e frytshme vullnetare që nxisin të mirën kombëtare[11 12].
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Po. UAMD, në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimin e tij, ofron një numër të madh programesh akademike studimi të cilat përbëjnë dhe fushën e veprimtarisë së tij. Misioni i Universitetit "A.Moisiu", Durrës dhe i Fakultetit të Biznesit si ndër Njësitë Kryesore të universitetit, është që, në mënyrë të vazhdueshme, të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e çdokujt që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë [13 14 15 16].

[1]Aneksi Nr.1 Mendimi i Dekanit
[2]Aneksi Nr.2 Statuti i UAMD, Neni 2,3,4
[3]Aneksi Nr.3.Plani strategjik 2016-2020 i zhvillimit UAMD, fq. 22,23
[4] Aneksi Nr.3.1 Plani i zhvillimit strategjik te UAMD 2020-2025, fq. 22,23.
[5]Aneksi Nr. 3.2 Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025
[6]Aneksi Nr.4 Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MTMHR
[7]Aneksi Nr.4.1 Plani Strategjik i zhvillimit i DT.
[8]Aneksi Nr.7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.
[9]Aneksi Nr.1 Mendimi i Dekanit
[10]Aneksi Nr. 2 Statuti i UAMD, neni 2,3,4.
[11]Aneksi Nr. 52 Kodi i Etikës UAMD.
[12]Aneksi Nr. 5 Rregullore e Institucionit Arsimit të Lartë, UAMD.
[13]Aneksi Nr.3. Plani strategjik 2016-2020 i zhvillimit të UAMD, neni 2,3,4.
[14]Aneksi Nr. 3.1 Plani i zhvillimit strategjik te UAMD 2020-2025 fq. 22,23.
[15]Aneksi Nr.3.5 Plani strategjik i zhvillimit të FB,
[16]Aneksi Nr.4.1 Plani strategjik i zhvillimit të DT.

	Programi i studimit, "MTMHR" plotëson kriteret në hartimin e tij dhe ofrohet në përputhje qëllimet dhe misionin e UAMD-së, FB si dhe fushën e veprimtarisë se tyre[17].
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Po. Programi i studimit "MTMHR" është hartuar dhe ju ofrohet studentëve në përputhje dhe në zbatim të Planit Strategjik të zhvillimit të Institucionit, UAMD. Drejtimet strategjike të zhvillimit të UAMD-së shprehen në Statutin e Universitetit[18] dhe në Planit Strategjik të zhvillimit të Institucionit, 2016-2020 dhe 20-25 [19] [20] Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UAMD-së, Planin strategjik të zhvillimit te FB dhe të DT,[21] [22] me vizionin e tij i cili përcakton që UAMD synon të jete nje institucion, ç'ka reflekton jo vetëm të përgatisë specialistë të kualifikuar të fushave përkatëse ku ofron edukim, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. [23] Plani strategjik i UAMD ndërthur vizionin për arsimin e lartë, në përgjigje të sfidave e të detyrave që burojnë nga procesi i Bolonjës. Në përputhje me zhvillimin strategjik të institucionit në kuadër të Planit Strategjik të zhvillimit të programit të studimit[24], synohet edukimi profesional dhe kërkimi shkencor në menaxhimin e: sistemeve të strukturave akomoduese, hoteliere e ekstra hoteliere e te gjithë sistemit HORECA. Misioni i programit lidhet me formimin e mirë me principet menaxhuese të sipërmarjeve hoteliere në drejtim të zhvillimit të turizmit modern dhe garantimit të cilësisë së shërbimeve turistike. Arritja e këtij objektivi madhor fokusohet në, sigurimin e menaxhimit të mirë e të sukseshëm të ketyre sipërmarrjeve turistike, e nevojshshme kjo, jo vetëm për rritjen e numrit të turistëve por edhe rritjen e cilësisë së shërbimeve turistike e për rrjedhojë, të cilësisë së produktit turistik.
Kriteri 4. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Po. UAMD, FB si dhe vete Departamenti i Turizmit dëshmon se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit "MTMHR", duke u përkrahur dhe asistuar dhe nga personeli ndihmës akademik.[25], [26],[27],[28],[29].
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas	Po. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit "MTMHR" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë DT, përgjegjëse për këtë program[30] [31] sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane. Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e Europiane[32],[33].

[17]Aneksi Nr.7 Rregullore e programit të studimit MTMHR
[18]Aneksi Nr.2 Statuti i UAMD (aktual)
[19]Aneksi Nr.3 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2016-2020, fq 22, 23.
[20]Aneksi Nr.3.1 Plani i zhvillimit strategjik te UAMD 2020-2025 fq 22,23.
[20]Aneksi Nr. 3.2 Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2016-2020.
[21]Aneksi Nr.3.2 Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2016-2020.
[22]Aneksi_Nr.4.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Turizmit.
[23]Aneksi Nr.3 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2016-2020.
[24]Aneksi Nr.4 Plani i zhvillimit strategjik të programit të studimit MTMHR
[25]Aneksi Nr. 21 CV e personelit akademik në MTMHR.
[26]Aneksi Nr. 22 CV e personelit ndihmës akademik në MTMHR.
[27]Ankesi Nr. 43 Të dhënat për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimit shkencor për anëtarët e departamentit në 5 vitet e fundit.
[28]Aneksi Nr. 65 Fushat e studimit të lektorëve të Departamentit të Turizmit.
[29]Aneksi Nr. 108 Orari mësimor
[30]Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit.
[31]Aneksi Nr.7 Rregullore e Programit të studimit: "Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim Hotel-Restorant".
[32]Aneksi Nr.61 VKM Nr.531, datë 11.9.2018, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë".
[33]Aneksi Nr.31 Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 802015)

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi I.2 **Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Po. Departamenti i Turizmit për mbarëvajtjen e punës në drejtim të zbatimit të programit mësimor në "*MTMHR*" ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi brenda fakultetit me departamente të tjera për të mundësuar realizimin e efektiv të objektivave që ka ky program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës në fuqi.[34 35 36 37]. Realizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit ka qënë i nevojshëm për mbulimin e lëndëve e moduleve që përbëjnë kurrikulën e këtij programi studimi dhe që zhvillohen nga lektorë jashtë departamentit.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Po. Për realizimin e objektivave të programit të studimit si dhe procesit mësimor e formues të studentëve, FB si njësi kryesore e UAMD ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj[38 39 40] .
Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Po. Në kuadër të realizimit të programit të studimit "*MTMHR*", UAMD dhe FB ka nënshkruar disa marrveshje institucionale në nivel lokal dhe kombëtar si dhe biznese e kompani private që operojnë në fushën e turizmit.[41] Qëllimi i nënshkrimit të këtyre bashkëpunimeve ndër të tjera është dhe realizimi i aftësimit praktik profesional të studenteve pranë këtyre institucioneve ose kompanive[42 43] .
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Po. Departamenti i Turizmit në analizën vjetore të punës ka analizuar dhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Në kuadër të bashkëpunimeve janë realizuar shkembime të stafit akademik dhe atij administrativ si dhe studentëve. Gjithashtu janë realizuar aktivitete informuese krahas dhe leksione të përbashka.[44 45 46]

[34]Aneksi Nr.2 Statuti i UAMD.
[35]Aneksi Nr.5 Rregullore e UAMD.
[36]Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit.
[37]Aneksi Nr.6.1 Rregullore e Departamentit të Turizmit.
[38]Aneksi Nr. 34.1 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet.
[39]Aneksi Nr. 34. Marreveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Biznesit në rang universiteti.
[40]Aneksi Nr. 17 Panairi i Punës 2022 dhe forumi i karrierës.
[41]Aneksi Nr.64 Marrëveshje bashkëpunimi të Departamentit të Turizmit me subjekte të ndryshme ente publike e private.
[42]Aneksi Nr.4 Plani i Zhvillimit Strategjik të programit te studimit MTMHR.
[43]Aneksi Nr.17 Panairi i Punës 2022 dhe forumi i karrierës.
[44]Aneksi Nr.35 Raport analitik mbi përfitimet nga marëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve.
[45] Aneksi Nr 73.1 Tabele permbledhese per mobilitett te stafit akademik te DT
[46] Aneksi Nr 125.1Shembull mobiliteti Gelsomina Domi

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 **Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). **L.80.2015: Neni 73, Pika 1.**	Po. Programi i studimeve "Bachelor` në `MTMHR" është i strukturuar në përputhje me Ligjin 80/2015, dhe aktet e tjera ligjore[47] e nënligjore [48] [49]. Struktura e programit të studimit shprehet në ndërtimin e planit mësimor të detajuar dhe të miratuar dhe kurrikulës së programit të studimit[50]. Zbatimi i këtij programi studimi bëhet në përputhje me përcaktimet e Rregullores së programit të studimit[51]. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module të cilat, në Kurrikulën e programit dhe Planin mësimor shprehen nëpërmjet ngarkesës mësimore në orë mësimore që përmban çdo lëndë/modul. Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module, pesha e të cilave vlerësohet me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)[52]
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Po. Programi i studimit Bachelor në "MTMHR" ka si synim të tij pajisjen e studentëve me dijet e nevojshme profesionale dhe aftësimin e tyre për zgjidhjen e problemeve në fushën e menaxhimit te Hotelerise e Restorantit. Kuadri formues për këtë specialitet synon të ofrojë njohuri dhe kompetenca në realizimin e objektivave të politikave të mirëmenaxhimit të bizneseve të akomodimit dhe mikëpritjes në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshmërisë duke synuar krijimin e produkteve të marketueshme dhe qëndrueshmërinë në kohë të tyre. Fitimi i njohurive iu jep mundësi studentëve të jenë origjinalë në zhvillimin e ideve dhe zbatimin e tyre në kontekstin e kërkimit shkencor. Studentët fitojnë kompentenca në zbatimin e njohurive të fituara dhe kapacitetin e tyre për zgjidhjen e probleme të menaxhimit të bizneseve të mikpritjes kulturor brenda konteksteve më të gjëra (ose shumëdisiplinore) që lidhen me fushën e studimit të tyre. Këtë gjë e pasqyrojnë edhe syllabuset e lëndëve që përbëjnë programin mësimor[53] [54] të cilat kanë dhe transmetojnë një nivel të avancuar informacioni në këtë drejtim.[55].

[47]Aneksi Nr 59 VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 pika 2, Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë.
[48]Aneksi Nr. 5 Rregullore UAMD, Kreu III, neni 43.
[49]Aneksi Nr 6 Rregullore e FB, Kreu III, neni 36.
[50]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit te programit të studimit MTMHR.
[51]Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.
[52]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit te programit të studimit MTMHR.
[53]Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu III
[54]Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.
[55]Aneksi Nr. 59 VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" Syllabuset, pjesa e përmbledhjes dhe rezultateve të të nxënit dhe pjesa "Literatura bazë dhe ndihmëse.

VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.3	
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. **VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.5**	Po. Programi i studimit Bachelor në "MTMHR" është i hartuar në përputhje me përcaktimet ligjore për veprimtaritë formuese të tij duke i grupuar lëndët dhe modulet[56 57 58 59] sipas kategorive përkatëse te shprehura në ngarkesën mësimore me raportin e orëve dhe me kredite. Veprimtaritë formuese, që përbëjnë edhe pjesën kryesore të programit të studimit janë detajuar në program konform përcaktimeve ligjore. Në hartimin e kurrikulës të këtij programi studimi ka zhvillim të mirë te lëndëve karakterizuese, duke vendosur një raport të drejtë mes mësimit teorik e formimit praktik, duke u fokusuar kryesisht në aspektet praktike, për një formim më të mirë të studentëve dhe një thellim të njohurive tyre në fushën e menaxhimit te Hotelerisë dhe Restorantit. Po kështu hartimi i kurrikulës ka pasur në fokus rritjen e nivelit të njohurive të studentëve, ofrimin e mundësive për një aftësim më profesional të tyre, dhe një qasje me nevojat e tregut[60].
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. **VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.4**	Po. Programi i studimit Bachelor në MTMHR" ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e saj si dhe të detyrimeve përmbyllëse konform përcaktimeve ligjore[61 62].
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. **VKM nr. 41, Dt.18.01.2018: Pika 2.6 2.8** **L. 80/2015: Neni 84**	Po. Programi i studimit Bachelor në "*MTMHR*" përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit sipas përcaktimeve në aktet ligjore[63 64] e nënligjore në fuqi[65 66 67].Organizimi i një programi studimi, pranimi i studenteve dhe financimi i cili pasqyrohet në dokumentacionin e programit të studimit, mbështetet në hartimin e dokumentacionit themelor të tij që është: -Kurrikula e studimeve[68]; -Plani mësimor[69]; -Programet mësimore (Syllabuset) të lëndëve/moduleve përbërëse[70] -Rregullorja e programit të studimit[71]
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë	Po. Programi i studimit Bachelor në "MTMHR " është i hartuar në përputhje me përcaktimet ligjore.

[56]Aneksi Nr. 5 Rregullorja e Studimeve UAMD , Kreu III , Neni 41,43.
[57]Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu III, Neni 34,35,36.
[58]Aneksi. Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.
[59]Aneksi Nr. 59 VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".
[60]Po aty
[61]Anekset Nr 112 dhe 112.1, 112.2 Planet mësimore të programit të studimit, MTMHR për vitet akademike 2018-2021 dhe 2021-2024 si dhe relacioni per riorganizimi 2021-2024 Vendim Senati .
[62]Aneksi Nr. 59 VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", pika 2.4.
[63]Aneksi_ Nr 59 VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Shtojca 2
[64]Aneksi Nr. 59.1 Vendim Nr. 879, Datë 18.12.2019 "Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofruara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë " ".
[65]Aneksi Nr. 5 Rregullorja e studimeve UAMD, Kreu III, neni 43.
[66]Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB , Kreu III, nenet 34, 35, 36, 37.
[67]Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.
[68]Aneksi Nr. 14 Dosje e Riorganizimit të Programit të Studimit Bachelor në MTMHR
[69]Anekset Nr. 112 dhe 112.1 Planet mësimore të programit të studimit, MTMHR për vitet akademike 2018-2021 dhe 2021-2024).
[70] Aneksi Nr. 59 VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Shtojca 2.
[71] Aneksi_Nr.7 Rregullore studimi per programin MTMHR.

përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. **VKM nr. 879, Dt.24.12.2019: Shtojca 1**	Përqindja totale e lëndëve te kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70%[72] . Në hartimin e kurrikulës të këtij programi studimi ka zhvillim të mirë të lëndëve karakterizuese, duke vendosur një raport të drejtë mes mësimit teorik e formimit praktik, duke u fokusuar kryesisht në aspektet praktike, për një formim më të mirë të studentëve dhe një thellim të njohurive tyre në fushën e menaxhimit te Hotelerise dhe Restorantit. Po kështu hartimi i kurrikulës ka pasur në fokus rritjen e nivelit të njohurive të studentëve, ofrimin e mundësive për një aftësim më profesional të tyre, dhe një qasje me nevojat e tregut[73] [74]
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. **L. 80/2015: Neni 86, Pika1**	Po. Programi i studimit Bachelor në "*MTMHR*" shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.[75]
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Jo. Programi i studimit Bachelor në "MTMHR" aktualisht nuk është program i përbashkët.

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi II.2 **Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. **L. 80/2015: Neni 23, Pika23,25**	Po. UAMD ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në vitin 2016 si dhe në riakreditimin e dytë institucional në vitin 2022 përpara aplikimit për akreditimin e programit[76] të studimit Bachelor në "*MTMHR*". Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim[77] [78]. Respektimi i detyrimeve për të kaluar procesin e vlerësimit dhe të akreditimit, reflektohet në përputhshmërinë e Rregulloreve të studimeve [79] [80] në nivel fakulteti dhe program studimi, me Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e

[72] Aneksi Nr. 59.1 Vendim Nr. 879, Datë 18.12.2019 "Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofruara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë" "
[73] Po aty.
[74] Po aty.
[75] Aneksi Nr. 31 Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80:2015.
[76] Aneksi Nr. 5 Rregullorja e Studimeve UAMD , Kreu III
[77] Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu III, Neni 34.
[78] Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.
[79] Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu III, Neni 34.
[80] Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.

	Shqipërisë" dhe aktet nënligjore që rrjedhin nga ligji, si dhe në faktin që këto njësi kanë kaluar procesin e akreditimit institucional[81 82 83]. Rregullore e FB përcakton që FB harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. FB përdor instrumente të përshtatshme për sigurimin e cilësisë. Ai ka njësinë e tij të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike, e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore[84]. Standardet për sigurimin e cilësisë që hartohen nga FB, janë në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR nr 824,në datë 24.12.2021 Po Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e këtij program studimi, përmbushin të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me numrin e personelit akademik që ato kanë dhe në lidhje me shkallën e kualifikimit të personelit akademik [85], [86].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Po. Mbështetur në natyrën specifike të këtij programi studimi, personeli ndihmës akademik/administrativ angazhohet në kryerjen e praktikave mësimore në terren, sipas detajimit të programit mësimor të përcaktuar në syllabuset e lëndëve/moduleve[87] dhe të përcaktuara në planet kalendarike sipas javëve. Personeli ndihmës akademik/administrativ i departamentit që është i përfshirë në zbatimin e këtij programi studimi, kanë një nivel të kënaqshëm kualifikimi[88] (në pjesën më të madhe të tyre kanë kryer ciklin e dytë të studimeve,). Ata krahas ndjekjes së procesit mësimor janë të angazhuar edhe në kryerjen e punës kërkimore shkencore pranë laboratorit, që është pjesë e Fakultetit dhe e Departamentit dhe ku kryhen punët laboratorike për të gjitha lëndët/modulet që në planin e tyre mësimor kanë parashikuar punë laboratorike.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. **L. 80/2015: Neni 25, Pika 4**	Po. Fakulteti i Biznesit si njësi kryesore, pjesë e të cilit është Departamenti i Turizmit, përmbushin të gjithë detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me caktimin e një personi në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij[89 90 91]

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi II.3 **Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**	
Kriteret	**Vlerësimi**

[81]Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu III, Neni 34.
[82]Aneksi_Nr.7 Rregullore e programit te studimi MTMHR.
[83]Aneksi Nr. 8 Rregullore e NJSBC Kreu III Neni 11.
[84]Aneksi Nr 6 Rregullore e FB, Kreu III, Neni 34.
[85]Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu II, Neni 19.
[86]Aneksi Nr. 23 Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.
[87]Aneksi Nr 20 Syllabuset e lëndëve.
[88]Aneksi Nr. 22 CV e personelit ndihmës akademik.
[89]Aneksi Nr. 6.1 Rregullore e Departamentit të Turizmit.
[90]Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu II.
[91]Aneksi Nr. 36 Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. **VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.6, shkr "i" ii**	Po. Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit, jane përgjegjës për zbatimin e këtij programi studimi të ciklit të parë në *"MTMHR"*, disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit[92]. Ky informacion pasqyrohet në Rregulloren e Studimeve në nivel Fakulteti dhe ne Rregulloren e programit të studimit e në nivel departamenti[93]. Në planin mësimor të programit të studimit, lëndët e programit të studimit janë të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në semestra[94]të tij.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. **VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2. 5,2.6**	Po. Programi i studimit në "MTMHR", është i organizuar konform përcaktimeve ligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore [95,96] Programi i studimit është i organizuar dhe i ndarë në lëndë e module, praktika e aktivitete formuese gjë e cila pasqyrohet në planin mësimor e kurrikulën e studimeve[97]. Plani mësimor është i detajuar sipas Veprimtarive Formuese të tipit A, B, C, D, E dhe F (sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018), "Për Elementët eProgrameve të Studimit" dhe i përmbahet këtij akti nënligjor [98 99]. Ndarja e lëndëve dhe moduleve në planin mësimor i përgjigjet plotësisht këtyre kategorive të përcaktuara[100]. Në planin mësimor të këtij program studimi përcaktohen lëndët/modulet e programit të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese: A – Lëndë Bazë B – Lëndë Karakterizuese C – Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese D – Lëndë Plotësuese E – Lëndë Detyrime Përmbyllëse Programi i studimit është 3 vite studimi me 6 semestra, secili semestër me 15 javë mësimore. Ky organizim i programit shprehet në planin mësimor dhe në kurrikulën e tij[101]. Ky kategorizim i lëndëve/moduleve në planin mësimor dhe organizimi i kurrikulkës së studimit në vite e semestra i shërben plotësisht formimit profesional të studentëve në këtë program studimi.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. **L.80/2018: Neni 75, 76, 89** **VKM nr. 41,** Dt.**24.01.2018: Pika 2.7**	Po. Programi i studimit Bachelor në "*MTMHR*", zbaton Rregulloren e Studimeve të Universitetit UAMD-së[102], Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Biznesit [103] dhe Rregulloren e programit të studimit në `bachelor [104], në të cilat përmbahen të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Programi i studimit është i hapur dhe transparent me publikun. Për ta bërë atë sa më atraktiv për studentët me qëllim tërheqjen e tyre, ai përdor politika marketingu që lidhen më rritjen e transparencës përballë publikut[105].

[92]Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB Kreu III, 29, 30.
[93]Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit të studimit MTMHR.
[94]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit 2021-2024.
[95]Aneksi Nr. 6. Rregullore e FB, Kreu III.
[96]Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.
[97]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizmit të programit të studimit.
[98]Aneksi Nr. 59 VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*".
[99]Aneksi Nr. 59.1 Vendim Nr. 879, Datë 18.12.2019 "*Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofruara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë"* ".
[100]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit.
[101]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit.
[102]Aneksi Nr. 5 Rregullorja e studimeve UAMD , Kreu III, neni 56,57.
[103]Aneksi Nr 6 Rregullore e FB, Kreu III neni 42, 43, 44.
[104]Aneksi Nr 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.
[105]Aneksi Nr. 51 Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparenca me publikun.

Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. **VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.8**	Po. Kurrikula e programit të studimit Bachelor në "*MTMHR*", i përgjigjet misionit dhe objektivave të Departamentit të Turizmit. Përputhshmëria e ndërtimit të kurrikulës evidentohet në objektivat e detajuara që ka secila kategori te grup lëndëve dhe lëndëve të veçanta që përbëjnë programin, të cilat dallohen për nivelin e lartë e bashkëkohor të informacionit që sjellin për studentët si dhe në një renditje logjike të tyre në funksion të formimit të studentëve sipas profilit përkatës, duke mos krijuar përsëritje të tyre, por duke dhënë një informacion të detajuar me drejtim Hotel-Restorat[106], [107]. Plani mësimor i programit të studimit hartuar për zbatimin e kurrikulës mbështetet, për të qënë koherent, çdo vit me hartimin e programeve lëndore syllabuseve[108]. Syllabuset përmbajnë informacione të përgjithshme si titulli i lëndës/modulit, emrin e titullarit që e zhvillon, ngarkesën në orë dhe kredite, tipologjinë e lëndës (kategorinë), vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda, llojin e lëndës, programin mësimor të cilit i përket, kodin e lëndës/modulit dhe adresën elektronike të titullarit të lëndës. Në pjesën tjetër, ai përmban përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit, koncepte themelore mbi të cilat ndërtohet lënda, temat e lëndës, ndarë në javë sipas semestrit, praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, format e kontrollit të dijeve (masën e frekuentimit dhe mënyrat e kontrollit të vazhdueshëm, mënyrën dhe peshën e vlerësimit), shoqëruar në fund nga burimet e literaturës bashkëkohore e të përditësuar në mbështetje të programit të lëndës[109]. Syllabuset, me të gjithë elementët e mësimit që përmbajnë janë hartuar në përputhje me formatet ligjore të përcaktuara[110] [111]. Syllabuset e lëndëve hartohen nga titullari i lëndës/modulit, shqyrohet në departament dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit. Në fillim të çdo semestri, pedagogu që zhvillon modulin harton planin kalendar të ndarë në javë dhe orë mësimore sipas planit mësimor të miratuar[112]. Dosja e plotë e programit të studimit në "MTMHR", përmban të gjitha informacionet e detajuara për programet lëndore/syllabuset të cilët përmbajnë të gjithë elementët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, formatuar në përputhje me formatet e miratuara nga aktet nënligjore[113].			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Po. Programi i studimit në "*MTMHR*", është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. Ky program përmban syllabuset e vitit 2019-2023 [114] [115] [116].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

[106]Aneksi Nr. 5 Rregullorja e studimeve UAMD, Kreu III, neni 60, 61, 62, 63, 68, 69, 70.
[107]Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu III, nga neni 46 deri te neni 55.
[108]Aneksi Nr. 59 VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", pika 2.8 (Syllabuset).
[109]Po aty.
[110]Po aty.
[111]Aneksi Nr. 59.1 Vendim Nr. 879, Datë 18.12.2019 "*Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofruara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë"*".
[112]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit.
[113]Aneksi Nr. 59. VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*"., pika 2.8 (Syllabuset).
[114]Aneksi Nr 6 Rregullore e FB
[115]Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit të studimi MTMHR.
[116]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit.

Standardi II.4 **Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Po. Programi i studimit në ciklin e parë të studimeve në "MTMHR", bazohet në kurrikulën e hartuar, e cila detajohet në bazë të planit mësimor dhe syllabuseve[117]. Emërtimi i lëndëve që përmban ky program studimi, kategorizimi dhe shpërndarja e lëndëve që e shoqërojnë atë, janë të tilla që u mundësojnë studentëve të këtij programi studimi mundësinë e thellimit dhe zhvillimit të dijeve si dhe aftësive praktike e profesionale në fushën e menaxhimit te hoteleve restoranteve etj.[118]. Programi "*MTMHR*", ofron njohuri të mira në fushën e menaxhimit te hoteleve, restoranteve duke rritur mundësitë për karrierë profesionale të drejtuesve te ketyre bizneseve turistike ne nivel rajonal e kombëtar. Duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale bën të mundur punësimin e të diplomuarve në biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme të industrisë së turizmit, si: hotele, resorte, njesi hoteliere dhe ekstrahoteliere.[119] Kjo strukturë e programit të studimit në "*MTMHR*"' është ndërtuar dhe shkon në perputhje me Ligjin për Arsimit e Lartë (80/2015)[120] dhe Direktiva 2015/36 EC e Parlametit Europian dhe KE[121].
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Po. Programi "MTMHR" ka objektiva të shprehura qartë, në funksion të përvetësimit të dijeve dhe formimit të kompetencave profesionale të studentëve që lidhen me programin. Objektivat kryesore te këtij programi jane *1.Të përgatisë personel të aftë në sektorin e mikëpritjes.* *2.Të tranferojë tek studentët njohjen e ekonomisë, menaxhimit dhe teknikat organizative në lidhje me akomodimin turistik.* *3. Të transferojë konceptet kryesore teorike për organizmin e bizneseve të turizmit nga pikëpamja ekonomike- financiare e strukturore.* *4. Të pajisë studentët me aftësi të përparuara në zhvillimin, promovimin dhe komunikimin e ngjarjeve kulturore në konteksin e strukturave hoteliere dhe jashtë tyre.* [122]. Përcaktimi në kurrikulën e programit të studimit organizuar mbi bazën e lëndëve ose moduleve, detajimi i kurrikulës së studimit nëpërmjet planit mësimor dhe shpërndarja e tyre në 3 vite akademike, i ndarë në 6 semestra, dhe i vlerësuar me orë mësimore e kredite (ECTS), mundëson arritjen e objektivave formuese të programit dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit[123]. Ky strukturim i programit të studimit jep njohuri dhe rrit aftësimin profesional të studentëve. Programi është në shërbim të formimit të kërkuar të studentëve në fushën e menaxhimit te nderrmarrjeve hoteliere dhe nevojave të tregut të punës[124]

[117]Po aty.
[118]Po aty.
[119]Aneksi Nr. 16 Studimi për tregun e punës në programin MTMHR
[120]Aneksi Nr 31 Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane.
[121]Po aty.
[122]Aneksi Nr 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.
[123]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit 2021-2024.
[124]Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit të studimit MTMHR.

Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Po. Programi i studimit "*MTMHR*" është i strukturuar sipas përcaktimeve ligjore, duke kategorizuar veprimtaritë formuese, ku peshën kryesore e kanë lëndët/modulet karakterizuese, të cilat janë tërësisht në përputhje me profilin e programit në[125]. Lëndët dhe modulet që ai përmban dhe emërtimi i tyre janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e studimit për ciklin e parë të studimeve "*MTMHR*". Ngarkesa që ai përmban në orë mësimore (4500orë) dhe kredite (180 ECTS), i përmbahen përcaktimeve ligjore për këtë cikël studimi dhe e përafron atë me programe të tjera të ngjashme ndërkombëtare[126].
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. **VKM nr 879,date 18.12.2019 shtese ne VKM nr 41**	Po. Në programin e studimit, "*MTMHR*" ndarja e veprimtarive formuese e cila jepet e detajuar në planin mësimor dhe e përcaktuar në syllabuset e lëndëve dhe moduleve dhe një raport teori – praktikë i ekuilibruar ndërmjet tyre, krijojnë mundësinë për një formim të plotë të studentëve, ne perputhje me drejtimin dhe profilizimin si dhe objektivat formues të programit, gjë e cila u mundëson atyre transferimin e studimeve në institucione të tjera [127]. Duke qënë se ky program studimi, i cili peshën e rëndësisë e ka tek veprimtaritë formuese, të cilat përfaqësojnë disiplina të formimit karakterizues dhe lëndë bazë (jo më pak se 50%)[128] të kurrikulës, dhe raporti midis veprimtarive me karakter teorik e atyre me karakter praktik, u mundëson një formim më të mirë të studentëve[129].
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Po.Programi i studimit, "*MTMHR*" perditësohet dhe në të gjitha syllabuset e lëndëve literatura e përdorur është ajo e 5 viteve të fundit[130] [131]
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Po. Programi i studimit "*MTMHR*" është një program i plotë dhe në funksion të qëllimit për të cilin është hartuar[132]. Ai është ndërtuar dhe ka në përmbajtjen e tij lëndë dhe module specifike të veprimtarive formuese, ku dominojnë disiplinat e formimit karakterizues, por edhe disiplina të formimit bazë të përgjithshëm, të cilat krijojnë të gjitha kushtet për arritjen e objektivave që synon programi[133]. Përmbajtja e programit u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat përbëjnë edhe synimet kryesore të këtij programi të përcaktuara edhe në rregulloren e studimeve të programit[134]. Përmbajtja e syllabuseve të lëndëve, të cilat japin në mënyrë të detajuar përmbajtjen e çdo lënde, te shprehura nëpërmjet temave që zhvillohen gjatë trajtimit të disiplinave përkatëse e garanton këtë gjë[135].
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje	Po[136] Programi Bachelor në "MTMHR" ofron njohuri të mira në fushën e turizmit duke rritur mundësitë për karrierë profesionale të drejtuesit të institucioneve kulturorë rajonalë e kombëtarë. Duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale bën të mundur punësimin e të diplomuarve në biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme të industrisë së turizmit, si: hotele, resorte, njesi hoteliere dhe

[125]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit 2021-2024.
[126]Po aty.
[127]Po aty.
[128]Aneksi Nr. 59.1 Vendim Nr. 879, Datë 18.12.2019 "*Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofruara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë"*".
[129]Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit.
[130]Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit të studimit MTMHR.
[131]Aneksi Nr. 20 , Syllabuset e MTMHR 2021-2024 pjesa "Literatura bazë dhe ndihmëse.
[132]Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit të studimit MTMHR.
[133]Po aty.
[134]Po aty.
[135]Aneksi Nr. 20 Syllabuset, pjesa "Temat e lëndës".
[136]Aneksi Nr. 20 Syllabuset, pjesa "Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit".

me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	ekstrahoteliere.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi II.5 **Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**				
Kriteret	**Vlerësimi**			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Po. Konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës lidhur me përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen e tij sa më mirë me kërkesat e tregut e punës[137] [138]			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Po. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektohen kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.[139] [140] [141]			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Po. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me kerkesat e tregut[142]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

[137]Aneksi Nr. 19Njoftim bizneseve turistike dhe shoqatave te sektorit per programin.
[138]Aneksi Nr. 34 Marrëveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Biznesit.
[139]Aneksi Nr. 51.2 Takim Alumni Turizëm 2018-2019.
[140]Aneksi Nr. 51.3 Grupi i punës Alumni dhe aktivitetet.
[141]Aneksi Nr. 72, 72, 1, 72.2 Permbledhja e pyetesorit te studenteve , Modeli i formularit te vleresimit te Google Form, Model ankete drejtuar studenteve te programit MTMHR
[142]Aneksi Nr. 17 Panairi i punës 2022, 2023 dhe forumi i karrierës.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 **Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Po. Për të patur një transmetim dhe përvetësim sa më të mirë të njohurive, procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, punët laboratorike, me detyra praktike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet provimit të ndërmjetëm dhe provimit përfundimtar. Ai u krijon mundësinë studentëve të identifikojnë mangësit në provimin e parë dhe ti plotësojnë ato në provimin përfundimtar. Format e mësimdhënies gjejnë pasqyrim dhe në rregullatorët mbështetës ligjorë[143],[144],[145],[146]. Vëmëndje e vecantë i kushtohet aftësimit praktik të studentëve nëpëmjet realizimit të praktikës profesionale, që synojnë thellimin e njohurive teorike dhe zbatimin konkret në praktikë të tyre, për ti aftësuar në ushtrimin e aktivitetit professional[147]. Në bashkëpunim me tregun e punës departamenti ushtron edhe formën e leksioneve të hapura si edhe lektorime të hapura në terren gjatë organizimit të vizitave studimore[148].
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Po. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve. Për këtë ka ndërthurur metoda pune në përshtaje me materialet që lektoron dhe nevojave të studentëve[149],[150],[151],[152][153]. Në orë të veçanta, në syllabuse të veçanta, përfshihen tema të aftësimit praktik (vizita studimore), si dhe gjatë realizimit të orëve si, detyrave të kursit individuale apo në grupe të vogla pune, duke stimuluar pavarësinë e kërkimit shkencor dhe njëkohësisht dhe metodikën e të punuarit në grup.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Po. UAMD mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Forma e mbështetjes janë të larmishme: 1. Nëpërmjet moduleve të trainimit për stafin akademik të ofruara nga Qendra për Edukim në Vazhdim pranë Fakultetit të Edukimit[154]; Tematika e moduleve lidhet me Metodat Novatore në Mësimdhënie; Platformat Tekonologjike në Mësimdhënie; Vlerësimin e Vazhdueshëm dhe Barazinë dhe Diversitetin 2. Nëpërmjet pjesmarrjes së personelit akademik të DT në mobilitete me fokus kryerjen e mesimdhënies dhe përfitime nga aktivitetet trajnuese në universitetet pritëse të huaja në kuadër të programit ERASMUS +[155];

[143]Aneksi Nr. 2 Statuti i UAMD, Kreu VI, Neni 72, pika 1-4.
[144]Aneksi Nr. 5 Rregullore e UAMD, Neni 60, Neni 61.
[145]Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Kreu III, Neni 51.
[146]Aneksi Nr. 14 Dosje e Riorganizimit Menaxhim Hotel-Restorant
[147] Aneksi Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit MTMHR,Neni 19.
[148] Aneksi 76 Vendim i Rektores per perzgjedhjen e lektoreve te ftuar dhe mbajtjen e leksioneve te hapura me studentet
[149] AneksiNr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Kreu III, Neni 51.
[150] Aneksi Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit MTMHR, Neni 17
[151] Aneksi Nr.81 Aktivitete te kryera nga lektoret e departamentit te turizmit, 2020-22);
[152] Aneksi Nr. 81.1 Lektorime te hapura nga anetaret e stafit e te ftuar ne ekspediten mesimore te zhvilluar ne terren), Aneksi 18.1 Lektorime te kryera nga lektore te programit Erasmus
[153] Aneksi Nr.18 leksione te hapura Axhenda e e aktiveteve te lektoreve te Haxhi Zekes
[154] Aneksi 39. Qendra per Edukim ne Vazhdim dhe metodat e mesimdhenies;
[155] Aneksi 38 Analizat vjetore dep Turizmit

	Shkëmbimet akademike kanë shërbyer në përmirësimin e mënyrës së organizimit të diskutimit, debatit dhe gjithëpërfshirjen në trajtimin e tematikave të ndryshme. 3. Nëpermjet vënies në dipozicion nga institucioni të mjeteve audio-vizive të teknologjisë dhe programe të veçanta kompjuterike për realizimin e orëve mësimore[156].
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Po. Personeli akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies është kompetent në përcjelljen e njohurive kjo sepse lëndët që ata mbulojnë janë në përputhje me fushat e studimit që zotërojnë dhe kualifikimet përkatëse. Këtë e dëshmojnë CV e personelit akademik dhe kualifikimet e vazhdueshme të tyre[157] të pasqyrura në formularët e kërkimit shkencor në rang departamenti[158]. Ketu perfshihen edhe formularet e vleresimit te lektoreve nga studentet.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Po. Departamenti i Turizmit si njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit MTMHR" synon përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit të procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të pyetësorëve të vlerësimit me studentët[159,160,161]. Mendimet e sygjerimet e studentëve të dala gjatë përpunimit të pyetësorëve kanë shërbyer si pika referimi të vlerësimit të punës nga stafi angazhuar në mësimdhënie duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave[162].
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Po. Institucioni ka struktura organizative në nivel institucional që në bazë të funksioneve dhe përgjegjësive që kanë promovojnë në vazhdimësi përmbushjen e standardeve te cilësisë në mësimdhënie duke koordinuar punën me njësinë kryesore e njësinë bazë për të mundësuar efikasitet në procesin e mësimdhënies. Strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në nivel institucional si dhe përgjegjesitë e tyre janë pasqyruar në Nenin 2 të rregullores së NJSBC[163]. Këto struktura janë në koordinim të përhershëm në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre me qëllimin e përbashkët koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve për të siguruar cilësi të mësimdhënies e kërkimit shkencor. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë pranë FB[164], mbështetur dhe në manualin për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë[165]ka realizuar raportin e vlerësimit të brendshëm për FB-it për vitin 2018-2019, ku analizohet puna e çdo njësie bazë në kontekstin e të gjithë Njësisë kryesore. Ne kuadër të kërkimit shkencor, institucioni ka hartuar një dokument idendifikues të arritjeve në drejtim të punës së kërkimit shkencor e kualifikimeve si individë dhe si njësi bazë e njësi kryesore. Në formë institucionale është realizuar dhe një rankim mbështetur në kritere pikëzimi ku janë idendifikuar e promovuar arritjet e lektorëve të veçantë si dhe njësive bazë në shkallë universiteti[166]. Organizimi i mësimdhënies në këtë program studimi të ofruar nga Departamenti i Turizmit mbështetet në kuadrin përkates ligjor të aprovuar[167], realizimi i programit

[156] Aneksi 136 Informim mbi pajisjet hardëere dhe sofwere te FB;
[157] Aneksi Nr.20 CV e Stafit Akademik në Bch MTHR
[158] Aneksi Nr.43 Tabelë përmbledhëse e aktivitetei kërkimor shkencor të 5 viteve të fundit të stafit akademik
[159] Aneksi Nr.40 Model Pyetesori i Studenteve
[160] Aneksi Nr.66 Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-2022
[161] Aneksi Nr.66.1 Monitorim i procesit te mesimdhenies nga NJSBC e FB
[162] Aneksi Nr.51.1 Ligji mbi mbrojtjen e te dhenave personale
[163] Aneksi Nr.8 Rregullore e NJSBC te UAMD, Pjesa I, neni 2
[164] Aneksi Nr.115 Njësia e Sigurimit te Brenshem te Cilesise per FB- vendimi
[165] Aneksi Nr.99 Manual I NJSBC te FB
[166] Aneksi 97 Relacion mbi aktivitetin kerkimor shkencor dhe rankimin e njesive ne UAMD
[167] Aneksi Nr.6 Rregullore e FB, Neni 21

	mësimor mbështetet në zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies duke përdorur programe specifike kompjuterike të rezervimit on-line, booking, apo duke i përfshirë në trajnime on-line në web ndërkombetar të trajnimit ne fushën e turizmit, psh: OTT[168]. Një aspekt tjetër është ndërthurja e orëve teorike me zhvillimin e tyre në formën e study field në kuadrin e përfshirjes së studentëve të programit të studimit'MTMHR" në ekspeditën mësimore të organizuar me studentët e ciklit bachelor në të tri profilet[169], [170] apo dhe të orëve individuale të organizuara nga lektorët e vecantë gjatë realizimit të programit mësimor[171]. Ndikim pozitiv ka patur përfshirja në mobilitete për mësimdhënie dhe trajnime në kuadër të programit Erasmus, duke përfituar gjërësisht nga shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet profesionistëve të fushës[172].

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi III.2 **Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Po. Mënyra e vlerësimit dhe kritereve të njohurive, dijeve e aftësive profesionale përcaktohen në rregulloret e veçanta që shërbejnë si bazë të punës së UAMD; FB dhe DT si dhe në rregulloren e programit të studimit. [173], [174],[175],[176]. Pjesë e çdo syllabusi lëndor është dhe rubrika e vlerësimit, ku është e përcaktuar mënyra e realizimit të testimit dhe sistemi i vlerësimit kundrejt pikëve në përqindje. Këto elementë i bëhen të ditur studentëve gjatë prezantimit me lëndën në orëë e parë të mësimit të çdo semestri, si dhe për dijeni të tyre u jepen në version hard copy syllabuset lëndore[177].
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Po. Në fillimi të çdo semestri titullari i lëndës informon studentët lidhur me programin lëndor, literaturën bazë e ndihmëse si dhe mënyrën e sistemin e vlerësimit.[178] Studentëve ju bëhet me dije struktura e lëndës dhe përqindjet e pikëvë për të gjithë elementët sipas përcaktimeve në syllabuset e lëndëve. Vlerësimi bëhet në dy etapa: Vlerësimi i parë i ndërmjetëm, në fund të javës së shtatë osë të tetë dhe provimi përfundimtar në fund të mbylljes së lëndës. Pjesë e vlerësimit në masën prej 10% të tij është dhe detyra e kursit/projektet e kursit[179], [180].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të	Po. Mënyra e kontrollit të dijeve përcaktohet në programin mësimor dhe i bëhet e njohur studentit në fillim të procesit mësimor nëpërmjet prezantimit të sillabuseve të lëndëve.[181] Mbështetur në rregulloret e UAMD, Rregulloren e FB si dhe në rregulloren e studimeve të programit të ciklit të parë Bachelor MTMHR", në këto baza ligjore janë

[168] Aneksi Nr.45.2 Link informues, www.onlinetraveltrainig.com, www.booking.com
[169] Aneksi Nr.86 Memo per organizimin e ekspedites mesimore me studentet e ciklit bachelor dhe rregullore
[170]
[171] Aneksi Nr87 Relacion per ekspediten mesimore
[172] Aneks_Nr.73.1 Tabele permbledhese mbi mobilitetin e stafit akademik per mesimdhenie te stafit DT
[173] Aneksi Nr.5 Rregullore e UAMD, Kreu III, Neni 62.
[174] Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 53.
[175] Aneksi Nr.10. Rregullore e Provimeve te FB, neni 4. Aneksi 10.1 Rregullore e tezes se Diplomimit ne FB
[176] Aneksi Nr.7 Rregullore e programit Bch në MTHR, Kreu III, Neni 23
[177] Aneksi Nr20 Silabuset e programit të studimit Bch në MTHR
[178] Aneksi Nr.6 Rregullore e FB, Neni 53
[179] Aneksi Nr.7 Rregullore e programit të studimit Bachelor Menaxhim Turizëm me profil"Hoteleri-Restorant", Kreu III, Neni 23
[180] Aneksi Nr.20 Syllabuset e programit të studimit Bch në MTHR 2021-2024
[181] Aneksi Nr.20 Syllabuset e programit të studimit Bch në MTHR 2021-2024

demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	përcaktuar edhe mënyrat dhe format e kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve dhe aftësive që kanë përvetësuar studentët gjatë zhvillimit të leksioneve teorike dhe aftësimit praktik, si: testimi i ndërmjetëm, detyrë kursi, provimi përfundimtar. [182], [183], [184], [185].
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Po. Institucioni synon përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit të procesit mësimdhënnies nëpërmjet përdorimit të pyetësorëve të vlerësimit me studentë. [186],[187]. Mendimet e sygjerimet e studentëve të dala gjatë përpunimit të pyetësorëve kanë shërbyer si pika referimi të vlerësimit të punës nga stafi angazhuar në mësimdhënie duke respektuar konfidencialitetin e te dhenave.[188]
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Po. FB-it mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, gjë e cila pasqyrohet dhe nga marrëveshjet ndërinstitucionale të bashkëpunimit të nënshkruara me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Në fokus të këtyre marëveshjeve qëndrojnë: shkëmbimet e personelit akademik (lektor, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, etj.; shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore[189], [190],[191]. Falë eksperiencës së fituar të lektorëve nga përfshirja në aktivitete shumëdimensionale të kryera në këtë kontekst, padyshim performanca e tyre mësimdhënëse ka reflektuar ndryshime cilësore pozitive. Në vijmësi stafi akademk i UAMD, si dhe i FB-it si pjesë institucionale e tij është përfshirë në mobilitete me fokus kryerjen e mesimdhënies në universitetet pritëse të huaja ashtu dhe përfitime nga aktivitetet trajnuese. [192] Përgjithësisht i gjithës stafi i lektorëve të departamentit i përfshirë në procesin e mësimdhënies në ciklin e studimeve MTHR përdor mjetet audio vizive të teknologjisë për realizimin e orëve mësimore si dhe përdorin programe të veçanta kompjuterike në funksion të kryerjes së rezervimeve on-line në sistemet e drejtimit të njësive akomoduese, por jo vetëm. Autonomia e studentëve permbushet nëpërmjet angazhimit të tyre gjatë mësimdhënies nëpërmjet përfshirjes në detyrat e kursit nëpërmjet punës me grupe kryesisht, realizimit të prezantimeve të gjetjeve të projekteve të realizuara. Marëdhëniet reciproke të respektit vendosen përgjatë një komunikimi verbal efektiv si dhe përgjatë komunikimit elektronik ndërmjet stafit akademik e studentëve përkundrejt mbajtjes së korespondëncës elektronike në adresën e e-mail-it ose faqes së facebook të departamentit e fakultetit.[193] Një tjetër aspekt është dhe përfshirja e tyre në konferencat studentore të organizuara nga njësia kryesore[194].

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

[182] Aneksi Nr.5 Rregullore e UAMD, Neni 68
[183] Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 59
[184]Aneksi Nr.7 Rregullore e Bch në MTHR, Kreu III, Neni 23
[185] Aneksi Nr 10.Rregullore e provimeve ne FB, neni 2
[186] Aneksi Nr.40 Model Pyetesori i Studenteve
[187] Aneksi Nr.66.1 Informacion mbi vleresimin e lektoreve te brendshem
[188] Aneksi Nr.51.1 Ligji mbi mbrojtjen e te dhenave personale
[189] Aneksi Nr.34 Marreveshjet e Bashkepunimit të Fakultetit të Biznesit.
[190] Aneksi Nr.109 Vendimi nga FB për përfshirjen e stafit në projekte (Histek, Interreg etj).
[191] Aneksi Nr. 73.1 Tabele permbledhese per mobilitetet e stafit akademik te DT.
[192] Aneksi Nr.73 Informacion nga DPMJ ne lidhje me mobilitetet e stafit akademik dhe administrative
[193] Aneksi Nr.106 Njoftime ne mediat sociale per pjesmarrje ne trajnime, mobilitete
[194] Aneksi Nr.85 Vendim per grupet e pune ne Konferencen Studentore

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Po. DT-it është njësia bazë përgjegjëse për zbatimin e programit të Studimit Bachelor MTMHR ". Mbështetur në rregulloren e UAMD[195], rregulloren e Fakultetit te Biznesit[196], rregulloren e programit të studimit[197] , ndjek dhe realizon në vijmësi në përputhje me kuadrin mbështetës ligjor procesin e vlerësimit të njohurive e dijeve. Procesi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që studenti ka arritur gjatë vitit bazohet në sistemin e vlerësimit me nota sipas klasifikimit të pikëvë të fituara. Forma e vlerësimit është e ndarë në pjesë: 1. Vlerësimi i ndërmjetëm në përfundim të 7-8 javëve të para të mësimdhënies është 40%; 2. Vlerësimi përfundimtar që zë në peshë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe kryhet në përfundim të mësimdhenies; 3. Vlerësimi me detyrë kursi/projekte që zë 10% të peshës së përgjithshme të vlerësimit total, dhe kryesisht realizohet para kryerjes së provimit përfundimtar. Skema e vlerësimit është pjesë përbërëse e syllabuseve mësimore dhe miratohet në fillim të vitit akademik nga përgjegjësi i njësisë bazë. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të lëndës janë: A. Testimi i ndërmjetëm; B. Detyrat e kursit; C. Projektet dhe provimi final. Lektoti i lëndës/modulit i komunikon studentit nëse ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në provimin final(perkundrejt rregullores mbi mungesat e kryera) si dhe nivelin e pikëve të fituara nga vlerësimi i ndërmjetëm dhe i detyrës së kursit në orën e fundit të mësimit para hyrjes në provimin përfundimtar. Provimi final, sipas përcaktimeve në syllabus, organizohet me shkrim. Studenti ka të drejtën e hyrjes në provim kur plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve, dhe i nënshtrohet provimit final. Studentëve i garantohet vlerësim objektiv bazuar në shkallën e meritës së tyre[198].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Po. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat, i shërbejnë rritjes së cilësise, transparencës, meritokracisë dhe bëjnë të mundur eliminimin e formave të ndryshme të abuzimit. Në programin e studimit Bachelor në`MTMHR" ka praktika të mira të zbatimit të sistemit elektronik të testimit dhe vlerësimit të përdorur random në ciklin bachelor, të mundësuar nga projekti Clean Score[199]
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Po. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve e aftësive realizohen në përputhje me bazën ligjore, rregulloret institucionale. Drejtuesi i Njësisë Bazë është përgjegjës për krijimin e komisioneve të provimeve me 3 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit, ndërsa antarët e tjerë pjesë e fushave të studimit të përafërt, në rastin e sezonit të riprovimeve. Komisioni i provimit në këtë rast përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për anën mësimore dhe miratohet nga dekani[200], [201].
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit	Po. Vlerësimi i njohurive e dijeve shoqërohet me komente e feedback në formë sqaruese e këshillash rekomanduese për përmirësimin e punës së studentit në drejtim të të nxënit. Proçesi i reflektimit realizohet në auditor orën pasardhëse të kryerjes së testimit. Në këtë orë studentët njihen me çelësin e zgjidhjes së tezës ku theksi vihet në pasaktësist e dhënies së përgjigjeve dhe të zgjidhjes së ushtrimeve të caktuara dhe

[195] Aneksi Nr.5 Rregullore UAMD, Neni 68.
[196] Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 59.
[197] Aneksi Nr.7 Rregullore e progamit bachelor MTHR, Kreu III, Neni 23.
[198] Aneksi Nr.10 Rregullore e provimeve ne FB, Neni 2.
[199] Aneksi 39.2 Vleresimi me sisteme elekktronike- Clean Score
[200] Aneksi Nr.5 Rregullore UAMD, Neni 69.
[201] Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 60.

për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	njëkohësisht jepen zgjidhjet e sakta[202], [203], [204]. Personeli akademik bën korigjimin në fletët e testit, shënime përkatëse sipas rasteve të shoqëruara këto edhe me komente verbale në kryerjen e vlerësimit të detyrës së kursit/projektit, si dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin gjatë kryerjes së procesit. Në rastet e mosdakortësisë me vlerësimin, konform rregulloreve, studentët kanë drejtën e ankimit brenda periudhës së përcaktuar në rregulloren e FB-it. Ata i drejtohen zv. dekanit për anën mësimore me anaë të një kërkese së paraqitur me shkrim. Drejtuesi i njësis bazë ngre një komision për të shqyrtuar ankimimin e studentit. Komisioni në fund të procesit del me një vendim që iu bëhët present palëve si studentit ashtu dhe lektorit përkatës.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Po. Personeli akademik zbaton me korrektësi dhe përgjejshmëri rregullatorët ligjorë kombëtar dhe institucional lidhur me tolerancën zero ndaj kopjimit në provime dhe plagjaturës në produktet e kërkimit të realizuara nga studentët. Përkundrejt cilësimit në aktet ligjore përkatëse, studentët nuk lejohen të hyjnë dhe të zhvillojnë provimin pa patur prezent mjetin e idendifikimit personal. Provimi zhvillohet me prani të lektorit përgjegjës për lëndën dhe lektorit asistues, që është personel akademik i DT-it. Në zbatim të rregullores së provimeve, lektorit të lëndës nuk i lejohet të fillojë provimin pa prezencën e lektorit asistues deri në momentin e zëvendësimit të tij me një lektor tjetër. Në ambientet e provimit nuk lejohen të hyjnë personel tjetër i pa autorizuar me përjashtim të autoriteteve drejtuese që mund të ushtrojnë funksione vëzhguese të zhvillimit të provimit. Nëse, studentët janë në kundravajtje ligjore me atë ç'ka citojnë rregulloret për mbarëvajtjen normale të provimit, lektorët janë të detyruar të përjashtojnë studentin nga kryerja e provimit. Në këtë rast plotësohet një procesverbal bashkëlidhur me fletën e provimit të studentit që vërteton kundravajtjen ligjore dhe justifikon masën e marrë për përjashtim nga provimi. Gjatë kryerjes së provimit është e ndaluar mbajtja e celularit në ambientet ku kryhet provimi[205], [206].
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Po. Procesi i kontrollit të dijeve bazohet në vlerësimin e njohurive të dijeve në bazë të meritës. [207] Çdo personel akademik lë gjurmë në fletën e testit të studentëve, duke bërë shënimet përkatëse për çdo pyetje që përmban fleta e tezës. Vëmëndje i kushtohet hartimit të tezës me larmishmëri pyetjesh në përputhje me peshën specifike që kanë objektivat lëndorë., duke respektuar parimet e vlerësimit. Tezat nënshkruhet nga përgjëgjësi i njësië bazë dhe nga lektori i lëndës. Në rastet e provimit të vjeshtës, teza nënshkruhet nga komisioni dhe drejtuesi i njësisë bazë. Në të përfshihet i gjithë materiali i zhvilluar lëndor. Rezultatet e provimit pasqyrohen në procesverbalet përkatëse jo më vonë së pesë ditë për provimin e parë të ndërmjetëm dhe brenda 72 oresh për provimin përfundimtar. Provimet zhvillohen me shkrim[208], [209], [210].
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut,	Po. Pas vlerësimit të provimit, me studentët realizohet procesi i transparencës në auditor, ku çdo student njihet me vlerësimin dhe konsulton fletën e testit me lektorin përkatës për t'u sqaruar më shumë mbi gabimet e bëra dhe zgjidhjen e drejtë të duhur[211],[212], [213]. Pas kësaj etape vlerësimet pasqyrohen në procesverbale. Në rast pakënaqësie të studentit kundrejt procesit të vlerësimit

[202] Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit Biznesit, neni 60, pika7.
[203] Aneksi Nr. 5 Rregullore e UAMD, Neni 69, pika 7.
[204] Aneksi Nr.10 Rregullore e provimeve, Pika 4.
[205] Aneksi Nr.5 Rregullore UAMD, Neni 70.
[206] Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit Biznesit, neni 61.
[207] Aneksi Nr.5 Rregullore UAMD, neni 69.
[208] Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, neni 69.
[209] Aneksi Nr.7 Rregullore e Bachelor Menaxhim Turizmi me profil "Hotel-Restorant" neni 26, 27.
[210] Aneksi Nr.10 Rregullore provimi, Pika 4.
[211] Aneksi Nr.5 Rregullore UAMD, neni 71.
[212] Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, neni 62.
[213] Aneksi Nr.10 Rregullore e provimeve, pika 6.

rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	nga lektori, studenti ka të drejtën e ankimimit të vlerësimit të bërë. Mos dhënia në kohë e rezultateve të provimit sikundër parashikohet në rregullore ngarkon me përgjegjësi për lektorin e lëndës. Provimet dorëzohen në sekretarinë mësimore ku ruhen sipas afatit kohor të përcaktuar në rregullore. Për çdo provim të kryer, një kopje e procesverbalit lëndor ruhet në njësiën bazë. Po. Në rast se studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin, ka të drejtën e ankimimit sipas akteve ligjore rregullatore. Pas paraqitjes së kërkesës ankimuese, drejtuesit të Njësisë Kryesore, fillon procedura sipas rregullores. Në rastet kur gjykohet, ankimimi i përcillet drejtuesit të njësisë bazë i cili ngre një komision për rivlerësim të tezës dhe bën me dije studentin dhe pedagogun për rezultatet. Në rast ndryshimesh, rezultati pasqyrohet në një procesverbal të dytë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankimimit depozitohet në dekanat dhe në arkivën e departamentit[214], [215].

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi III.4 **Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Po. Kurikula e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizëm me profil "Hotel-Restorant" është hartuar në mënyrë të tillë që të thellojë dijet dhe njohuritë në fushën e menaxhimit të hotelerisë dhe restoranteve, si dhe të aftësojë profesionalisht studentët.[216] Në këtë kurikul janë parashikuar lëndë/module ku studentëve i'u mundësohet marrja e njohurive të thelluara në lidhje me: Metodat e Kërkimit Shkencor, Kontabilitet Hotelier, Drejtim Hoteli, Drejtim Restoranti, Ekonomia e Destinacioneve Turistike, Menaxhim Eventesh, Marketing Turizmi, Promocion në Turizëm, Analizë Kosto, Investime në Turizëm, Turizëm Shqiptar, Ekonomi transporti[217]. Këto lëndë/module synojnë formimin e njohurive të qëndrueshme nga fusha e turizmit duke rritur mundësitë për karrierë profesionale të menaxhuesëve të sistemeve të akomodimit dhe ushqimit rajonal e kombëtar. Duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale që mundësojnë punësimin si specialist të ardhshëm në institucione publike apo biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme të industrisë së turizmit, si: pranë agjensive turistike të sektorit privat, Agjensia Kombëtare e Turizmit (AKT), pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), Unioni Turistik Shqiptar (UTSH), si dhe mundësi të mira për konsulencë të specializuar, etj. Praktika profesionale synon thellimin e njohurive teorike e profesionale të studentëve në drejtim të menaxhimit e drejtimit të ndërmarjeve turistike. Nëpërmjet marjes së informacionit bazë teorik në nivel të thelluar të ndërthuruar dhe me aftësimin e kompetencave profesionale synohet formimi i specialistëve të aftë në nivel vendimarrje për drejtimin e manaxhimin e ndërmarrjeve turistike.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të	Po. Programi i studimit Bachelor në MTMHR" i kushton vemëndje edhe formimit të studentëve me njohuri nga fusha e teknologjisë dhe informacionit, humane e sociale,

[214]Aneksi Nr.5 Rregullore UAMD, Neni 71.
[215] Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 62.
[216] Aneksi Nr.57 Urdheri i MASR per Hapjen e Programit te Studimit 25.8.2010.
[217] Aneksi Nr. 112. Plani mesimor per vitin 2018-2021, Aneksi 112.1 Plani mesimor per programin MTMHR 2021-2024.

veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	e komunikimit dhe ndërveprimit. Programi i studimit në planin e tij mësimor përmban lëndë: Multimedia dhe Komunikim, Kompjuterizim i ITC, Anglisht Turizmi, Menaxhim Ndërkulturor, Hyrje në Shkencat Politike. Këto lëndë mundësojnë dhe aftësojnë studentët të jenë më konkurues në tregun e punës, të krijojnë aftësi komunikative të mira, të aftësohen në fushën e IT-is në turizëm, të rrisin kompetencat e të punuarit në grup etj[218].
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Po. Në përfundim të çdo lënde aftësitë e kompetencat e fituara nga studentët bëhen objekt trajtimi në analizën vjetore të punës së departamentit të turizmit. Treguesit e analizuar janë niveli i frekuentimit, përqindja e kalueshmërisë, përqindja e notës mesatre dhe niveli i arritjeve sipas kategorizimit të sistemit vlerësues ECTS[219]. Mbështetur në gjetjet e analizës dhe diskutimit të tyre në njësinë bazë, personeli akademik bënë përmirësime të objektivave formues të lëndës, pasuron literaturën bazë dhe të rekomanduar me të rejat më të fundit të fushës që përfaqëson. Këtë proces e kryen në fillim të çdo semestri duke synuar rritjen e efektivitetit të mësimdhenies dhe zhvillim kompetencash. Literatura e përditësuar firmoset nga drejtuesi i njësisë bazë dhe personelit akademik përkatës që zhvillon lëndën[220], [221].
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Po. Mësimdhënia realizohet në bazë të kompetencave dhe objektivave lëndorë të përcaktuara në programin mësimor të çdo lënde. Në syllabuse pasqyrohen konceptet kyçe me të cilat duhet të pajiset studenti në përfundim të lëndës. Këto koncepte zhvillojnë tek studenti kompetenca profesional të përdorshëm në praktika profesionale si drejtimi i hotelit, drejtimi i restorantit, menaxhim resortesh, përdorimin e inovacionit në mikëpritje etj. Gjithashtu, një tjetër formë mësimdhënie e bazuar në kompetenca që zbatohet nga personeli akademik janë vizitat studimiore në institucione bashkëpunuese të tilla si; vizita studimore në Kompleskisin FAFA, Grand Blue FAFA, Resort Melia etj. Qëllimi i vizitave është njohja e studentëve nga afër me të gjithë departamentet e kompleskit (Front Office. Kuzhinë, Restorant). Në veçanti, në kompleksin Grand Blue FAFA, është trajtuar tema: Roli i FAFA Resort në realizimin e eventeve, si elementë i rëndësishëm në turizmin MICE[222]. Këto vizita i'u kanë dhënë mundësi studentëve të njihen nga afër me shumëllojshmërinë e profileve që kërkon tregu i punës në lëmin e mikpritjes dhe ofrimin e mundësive konkrete të punësimit.
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Po. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, të programit të studimit Bachelor në`MTMHR" angazhohet në realizimin e leksioneve të hapura me specialistë të ftuar të fushës, vendas dhe të huaj. Format e realizimit janë: 1. Ekspedita mësimore-studimore që zhvillohet në një periudhë një javore, në javën e fundit të vitit akademik në terren. Gjatë zhvillimit të ekspeditës, personeli akademik dhe specialistët e intitucioneve të përfshira në itinerar, zhvillojnë leksione të hapura në mbështetje të realizimit të objektivave që ka ekspedita[223]; 2. Leksione të hapura në auditor me specialist të fushës[224], [225]; 3. Leksione të hapura nga personel akademik të huaj në kuadër të shkembimeve akademike me institucione të huaja të arsimit të lartë, të programit ERASMUS +[226];

[218] Aneksi 112 Plani mesimor mesimor per vitin akademik 2018-2021 , Aneksi 112.1 plani mesimor per vitin 2021-2024
[219] Aneksi Nr.38.1 Analiza vjetore e punës e programit të studimit Bch në MTHR
[220] Aneksi Nr.20 Silabuset e MTMHR 2021-2024
[221] Aneksi Nr.6 Rregullore e FB, Neni 53
[222] Aneksi Nr.92 Relacion mbi leksion i hapur në organizimin e eventeve
[223] Aneksi Nr. 87 Relacion për ekspeditën mësimore
[224] Aneksi Nr.92 Relacion mbi leksion i hapur në organizimin e eventeve
[225] Aneksi Nr.18 Leksione të hapura, Kalendari i Aktiviteteve të Lektorëve të Universitetit "Haxhi Zeka", Kosovë
[226] Aneksi Nr 18.1 Lektorime te kryera nga lektore te Programit Erasmus

	Temat e trajtuara lidhen me zhvillimet dinamike që fusha e menaxhimit të sistemeve të akomodimit dhe ushqimit përfaqëson në vetvete[227].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standarti III.5 **Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Po. Fakulteti i Biznesit ka hartuar një rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar dhe punimin e diplomës. Ajo është e emërtuar: ***"Rregullorja e shlyerjes së detyrimeve përmbyllëse për studentët e programeve Bachelor në Fakultetin e Biznesit"***. Sipas Nenit 2, Kreu 1 të kësaj rregullore thuhet se: "Detyrimet përmbyllëse për studentët e ciklit të parë të studimeve në Fakultetin e Biznesit zhvillohen në dy forma: • Në rastin kur studenti ka një mesatare **mbi** notën 7, studenti i shlyen detyrimet përmbyllëse me përpilimin e mikrotezës dhe mbrojtjen e saj përpara një komisioni të posacëm. • Në rastin kur studenti ka një mesatare **nën** notën 7, studenti i shlyen detyrimet përmbyllëse duke zhvilluar provimin për mbylljen e studimeve"[228]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Po. Drejtuesi i DT dhe personeli akademik i tij asistojnë studentët dhe u vënë në dispozicion informacione dhe materiale të nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Në zbatim të Nenit 2, Kreu II të rregullores së *shlyerjes së detyrimeve përmbyllëse personeli akademik i DT* në fillimin të semestrit të dytë, të vitit të tretë të ciklit bachelor përgatit fondin e pyetjeve (nga 6 pyetje për çdo lëndë të disiplinës *LËNDË KARAKTERIZUESE* të kurrikulës së programit të studimit). Këto pyetje dorëzohen në departament dhe i vihen në dispozicion studentit sipas Nenit 1 të kësaj rregullore. Gjatë proçesit të përgatitjes për hartimin e mikrotezës studenti asistohet nga personeli akademik udhëheqës me materiale të nevojshme. Ai i rekomandon studentit literaturën ku do të mbështetet, institucionet që do ta aksesojnë me të dhëna apo i propozon forma të realizimit të grumbullimit të të dhënave cilësore[229].
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Po. Mbështetur në rregulloret e UAMD, Rregulloren e FB si dhe në rregulloren e studimeve të programit të ciklit të parë`MTMHR " dhe rregulloren e shlyerjes ë detyrimeve përmbyllëse, komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurive të dhëna në të tri vitet e studimit. Kështu sipas Nenit 2 dh 3 të rregullores së shlyerjes së provimeve përmbyllëse testimi hartohet duke përfshirë të gjitha lëndët e disiplinës LËNDË KARAKTERIZUESE, të cilat zënë edhe peshën më të madhe e më të rëndësishme në programin mësimor të programit të studimit Bch në MTMHR[230].
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës	Po. Bazuar në rr*egulloren e shlyerjes së detyrimeve përmbyllëse për studentët e programeve Bachelor në Fakultetin e Biznesit*" dhe rregulloren e Diplomimeve në FB, udhëheqësi i punimit të diplomës udhëzon dhe ndihmon studentin në përgatitjen e temës së diplomës[231], [232]. Ndërsa studentët njoftohen më parë me fushat e caktuara nga DT për realizimin e provimit përfundimtar, sipas rregullores së programit të studimi. Për të realizuar këtë proçes, udhëheqësi bashkëpunon me studentin duke caktuar dhe afate per kryerje të detyrave. Studenti me përgjegjshmërinë e tij duhet të respektojë afatet e vendosura për të mundësuar kryerjen me sukses të mbrojtjes së

[227] Aneksi 18.1 Lektorime te kryera nga lektore te Programit Erasmus
[228] Aneksi Nr. 10 Rregullore e Detyrimeve permbyllese bachelor
[229] Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit
[230] Aneksi Nr.10 Rregullore e Detyrimeve permbyllese bachelor; Aneksi Nr.6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit.
[231] Aneksi Nr.10 Rregullore e Detyrimeve permbyllese bachelor
[232] Aneksi Nr.10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit, neni 4-5.

sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	temës në sezonin e caktuar për mbrojtjen e diplomës. Udhëheqësi në bazë të një grafiku të krijuar për konsultime me studentin në udhëheqje, konsulton dhe kontrollon punën e bërë sipas planifikimit. Mbështetur në bazën ligjore udhëheqësi i punimit të diplomës garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo punimin[233]. Personeli akademik i DT shprehin gadishmëri maksimale për mbështetje të studentëve. Ata ndihmojnë studentët me sqarime në lidhje me organizimin e materilait, sipas fushave që ata mbulojnë.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Po. Personeli akademik i Departamenti të Turizmit në përputhje dhe me fushat e studimit dhe kualifikimit që zotërojnë asistojnë studentët për përmbledhjen dhe përpunimin e të dhënave sipas fushës së interesit dhe kërkimit që studentët janë fokusuar për realizimin e temës së diplomës[234], [235].
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Po. Në përfundim të procesit të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë nga komisioni. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit[236],[237].
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Po. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MASR. Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor MTMHR"[238]. Në përfundim të studimeve studentit i mundësohet kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, kundrejt kërkesës së tij. Për këtë ai ndjek standardin e rregullores së miratuar[239] , [240].
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Po. Në përputhje me rregullatorët ligjore institucioni kryen praktikat e duhura për ruajtjen e dokumentacionit, arshivimin dhe dhënien e informacioneve kur kërkohen ngë të interesuarit[241], [242], [243], [244].

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

[233]Aneksi Nr.10 Rregullore e Detyrimeve permbyllese bachelor, Kreu 3, Neni 3-4.
[234] Aneksi Nr.10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit, neni 4-5.
[235]Aneksi Nr.10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne FB. Neni 1-3.
[236] Aneksi Nr.10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit, Neni 11.
[237] Aneksi Nr.10.1 Rregullore e Tezës Diplomës në FB, Neni 10);
[238] Aneksi 15. 2 Diplomë dhe Suplement i Diplomës; Aneksi 15.1 Suplementi i ri MHR 2022-2023.
[239] Aneksi Nr.10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit.
[240] Aneksi Nr.15 Urdher Nr. 685date 25.08.2008 Regjistrimi i Formës së Diplomes Bch në MTHR.
[241] Aneksi Nr.9 Regullore e sekretarise se FB, Neni 27.
[242] Aneksi Nr.6 Rregullore e FB, Neni 74.
[243] Aneksi Nr.5 Rregullore e UAMD, Neni 84,89,90.
[244] Aneksi Nr.54 Rregullore per qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit, Neni 17,18.

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standarti IV.1 **Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi**
